



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 18.09.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 29.05.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë - Elbasan” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantoi projektligjin, Z. Damian Gjijnuri, ministër i Ministrisë për Infrastrukturën dhe Energjinë, dhe z. Erjon Luçi, Zv.Ministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan, në shumën prej 16 000 000 USD.

Objektivat kryesorë të projektit për riparimet emergjente të punimeve civile për segmentit nr.1, Sauk – Hyrje, Tuneli i Kërrabës, janë sigurimi i rrjedhës së pandërprerë të trafikut lidhur me pjesën tjetër të rrugës Tiranë-Elbasan, tashmë të përfunduar, ulja e kostos operative të automjeteve, ulja e aksidenteve rrugore, kursimi i kohës së udhëtimit dhe realizimi i rritjes ekonomike në zonën e projektit.

Riparimi emergjent i punimeve civile do të lejojë, gjithashtu, vënien në përdorim të plotë të rrugës Tiranë-Elbasan, me gjatësi prej 27 km, për të lehtësuar trafikun, duke siguruar mundësi më të shpejtë arritjeje në zonat bregdetare, në terrenet malore dhe zonat rurale të Elbasanit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me Maqedoninë dhe Greqinë fqinje, duke rritur aktivitetet tregtare, transitin dhe turizmin në Shqipëri.

Afati për përdorimin e këtij financimi shtesë, që do të akordohet nëpërmjet marrëveshjes në fjalë, është deri në datën 31 dhjetor 2019.

5.0 Efektet financiare

Huaja që do të sigurohet nga Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar ka termat e mëposhtëm:

- Shuma e financimit: 16 000 000 USD;
- Interesi: 2.75 % normë vjetore;
- Tarifa e shërbimit 1% normë vjetore që aplikohet mbi shumën e disbursuar dhe të pashlyer të kredisë;
- Maturimi: 20 vjet, duke përfshirë periudhën prej 5 vjetësh pa pagesë principali.

Në zbatim të ligjit nr.109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, si dhe udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.1.2018, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, është planifikuar dhe është i çelur buxheti për financimin e huaj të projektit.

6.0 Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjet dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive. Deputeti z. Adnor Shameti, shtroi pyetje në lidhje me kushtet financiare sa i takon ndarjes së linjave dhe të segmenteve të autostradës. Pas sqarimeve të përfaqësuesve të ministrisë Z. Damian Gjikhuri, Ministër për Infrastrukturën dhe Energjinë, dhe z. Erjon Luçi, Zv. Ministër për Financat dhe Ekonominë, komisioni votoi dhe më pas miratoi në parim, nën për nën dhe në tërësi projektligjin.

7.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë - Elbasan”, është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’ Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

